

VEPËR QË PASURON ETNOMUZIKOLOGJINË SHQIPTARE

Bahtir Sheholli, “VEÇORI MELOPOETIKE TË KËNDIMEVE TRADICIONALE (Studime etnomuzikologjike)”, botoi: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020; 255 f.



Në veprën “*Veçori melopoetike të këndimeve tradicionale*” të autorit Bahtir Sheholli janë përmbledhur punimet, që ky studiues i etnomuzikologjisë i ka botuar kryesisht në revistën shkencore të Institutit Albanologjik, *Gjurmime albanologjike - Folklor dhe etnologji* dhe në disa revista të tjera shkencore.

Që në fillimet e punës së tij, etnomuzikologu Bahtir Sheholli, punonjës shkencor në Degën e Folklorit, seksioni i etnomuzikologjisë, është marrë me regjistrimin e krijimtarisë muzikore të traditës fshatare dhe të asaj qytetare. Ai ka regjistruar me magnetofon, e ndonjëherë i ka filmuar me kamerë, këngët, meloditë, krijuesit dhe bartësit e kësaj krijimtari në ambientet autentike. Ka bërë transkriptimin e teksteve, melografinë e këngëve me nota muzikore dhe është

marrë me studimin dhe analizën e krijimtarisë muzikore popullore.

Punimet shkencore për zhanret e veçanta muzikore dhe për këndimin tradicional i ka trajtuar dhe analizuar në kontekstin historik dhe socio-kulturor, në rrafshin përmbajtjesor, përkatësisht në rrafshin tekst, artistik dhe muzikor - melodik, apo siç e thotë ai në rrafshin melopoetik.

Në punimin *Këngët lirike të dashurisë*, autori analizon tekstin e këngëve të dashurisë, tematikën, veçoritë specifike të motiveve, mënyrën se si krijuesi i këngës e ka imagjinuar rrëfimin, ndikimin e këngës jo vetëm si tekst, por edhe si krijim muzikor. E thekson faktin se këngët e dashurisë janë krijuar dhe janë kënduar kryesisht nga burrat. Dashuria ndaj femrës manifestohet si element thelbësor i këngës, përkatësisht si forcë frymëzuese e krijuesit të këngës. Në fund të punimit autori prezanton tekstet e transkriptuara dhe të melografuara të disa këngëve të dashurisë.

Këngët popullore fuqizim i përhershëm i veprimtarisë patriotike të Isa Boletinit është punim në të cilin

autori përmes shembujve, nxjerr në pah elemente të mjeteve formale, muzikore të të shprehurit dhe të mënyrës së interpretimit. Përmes analizës paraqitet evoluimi i këngës popullore të krijuar sipas modelit të këngëve epike me tematikë historike. Në fund, autori i paraqet shembujt me këngë të transkriptuara dhe të melografuara.

Mbi traditën muzikore të Llapit është punim në të cilin autori trajton folklorin muzikor dhe instrumentet tradicionale të rajonit të Llapit, duke e vënë theksin në këngët e dasmës, të cilat këndohen nga femrat, me dhe pa përcjellje të defit, duke i dhënë shembujt e transkriptuar dhe të melografuara.

Studimi *Shiitizmi, ilahie në traditën e dervishëve* i kushtohet një zhanri muzikor shumë specifik, i cili është krijuar brenda një sekti fetar të dervishëve bektashianë.

Autori trajton rrethanat që kanë ndikuar në lindjen dhe zhvillimin historik të shiitizmit e pastaj merret me analizën e ilahive të dervishëve shqiptarë, si formë e veçantë e këndimit. Trajton kushtet socio-kulturore që kanë ndikuar në lindjen dhe bartjen e tyre, kontekstin e interpretimit, bën analizën tekstore dhe artistike të këngëve si dhe analizën melodike të tyre. Në fund të punimit i jep shembujt e transkriptuar dhe të melografuara.

Në punimin *Mbi krijimtarinë poetiko-muzikore të këngëve lirike të ashikërisë*, këto këngë studiohen dhe konsiderohen si zhanër më vete. Këto këngë të krijuara dhe të kënduara nga

dervishët janë shtrirë në një shtresë të caktuar shoqërore dhe gradualisht janë bërë popullore dhe janë kënduar nga këngëtarët që kanë kënduar këngë të traditës fshatare, si dhe nga ata të traditës qytetare. Sipas autorit, tematika e këngëve është dashuria e besimtarëve ndaj Zotit, profetëve, imamëve, por edhe dashuria për atdhe. Sheholli analizon thellësisht rrafshin tekstor dhe melopoetik të këngëve dhe i prezanton tekstet e transkriptuara dhe të melografuara.

Vlerë e veçantë e të gjitha këtyre punimeve është se autori përveç analizës tekstore të këngëve bën dhe analizën e melodisë, si dhe i paraqet tekstet e melografuara, të cilat krijojnë mundësinë që këngët të mund të lexohen (me nota muzikore) dhe të këndohen edhe pas shumë vjetësh nga gjeneratat e ardhshme.

Është e ditur dhe e njohur se muzika popullore apo këngët popullore të traditës sonë gjithnjë evoluojnë dhe transformohen duke iu përshtatur kushteve të zhvillimeve të jetës bashkëkohore në rrethana të zhvillimeve të hovshme teknologjike.

Për dukurinë e zhvillimit të muzikës së traditës popullore në kushtet bashkëkohore dhe për faktorët që ndikojnë në evoluimin dhe transformimin e saj, Sheholli ka shkruar disa punime. Në këtë frymë është punimi: *Mbi traditën dhe krijimtarinë e re vokalo - instrumentale në folklorin muzikor shqiptar*, në të cilin jepet një pasqyrë përmbledhëse e muzikës popullore shqiptare në Kosovë, evoluimi i saj, mënyra e krijimit të formave të

reja, mënyrat e përdorimit të instrumenteve dhe formimi i orkestrave të çiftelive, mënyra e zhvillimit të instrumenteve kordofonike (çifteli dhe shar-ki), zhvillimi i tambureve dhe transformimi i formave muzikore në përgjithësi etj.

Në punimin *Mbi paraqitjen e folklorit shqiptar në skenë dhe disa dukuri aktuale folklorike autori* trajton problemin e prezantimit të folklorit shqiptar në skenë dhe disa fenomene folklorike bashkëkohore. Folklori trajtohet si një fenomen socio-kulturor, diskutohet mënyra e përpunimit dhe stilizimit të folklorit koreografik muzikor, transformimi i panatyrshëm i folklorit, falsifikimi i vlerave identitare shqiptare, roli dhe rëndësia e ve-shjeve të paraqitura në skenë etj.

Tradicionalja dhe bashkëkohorja në krijimtarinë tonë muzikore popullore është punim në të cilin theksohet se disa nga format që përmbajnë elemente të traditës së vjetër muzikore janë këngët e punës, këngët e ciklit kalendarik (këngët e motmotit), baladat, këngët epike të ciklit për kreshnikët, këngët e dashurisë etj.

Një ndër faktorët ndikues në evoluimin dhe transformimin e folklorit muzikor tradicional konsiderohet implikimi i instrumenteve muzikore të fabrikuara dhe të pajisjeve muzikore elektronike. Autori i këtyre punimeve i ka njohur në thelb instrumentet popullore me të cilat krijuesit, interpretuesit e kanë ekzekutuar (luajtur) muzikën popullore, prandaj edhe ka vënë në pah rolin e tyre në ruajtjen muzikës së traditës popullore, por gj-

thashtu ka theksuar edhe kushtet dhe rrethanat që ndikojnë në këto transformime.

Folklorizmin si dukuri të zhvillimit të muzikës dhe të krijimtarisë gojore në përgjithësi Sheholli e konsideron si proces të natyrshëm të zhvillimit dhe të evoluimit të kësaj krijimtarie, por thekson se folklorizmi ekstrem i shfaqur kohëve të fundit si kopjim i muzikës orientale, induse, sillave e të tjera, i cili aplikohet në emër të modernitetit, shpie në degradim dhe bastardim të muzikës së mirëfilltë të traditës sonë.

Sheholli, një kohë të gjatë, ka qenë seleksionues dhe përzgjedhës i këngëtarëve dhe valltarëve për prezantim në Festivalin Folklorik të Gillogocit si dhe për Festivalin Folklorik të Gjirokastërës.

Si përzgjedhës i materialeve muzikore të krijuesve dhe bartësve nga Kosova, për prezantim në Festivalin e Folklorit Kombëtar që mbahet në Gjirokastër dhe si vështrues i rregullt dhe i drejtpërdrejtë i këtyre festivaleve, ai shkroi disa punime të rëndësishme në të cilat trajton krijimtarinë e prezantuar në këto festivale, duke i dhënë rëndësinë dhe peshën krijimeve të traditës së mirëfilltë pa improvizime, si në rrafshin interpretues, ashtu dhe në rrafshin e përcjelljes me instrumente përkatëse muzikore. Një punim të veçantë ia kushton prezantimit të pjesëmarrësve nga Kosova, ku trajton gjerësisht: llojet e këngëve, këngëtarët e prezantuar, instrumentet me të të cilat janë përcjellë këngët, llojet e valleve dhe të kërcimeve, valltarët dhe

instrumentistët, veshjet e pjesëmarrësve etj. Ai insiston që në festivale të prezantohen ato zhanre që praktikohen më rrallë apo që janë në zhdukje e sipër, si bie fjala: këngët dhe ritet e motmotit, të cilat bartin elemente të riteve pagane, pastaj këngët e punës, këngët epike të ciklit të kreshnikëve që janë shoqëruar me lahutë, por edhe këngët me tematikë historike etj.

Etnomuzikologu Bahtir Sheholli me interesin dhe kërkimin e studiuesit ka përcjellë veprimtarinë e studiuesve dhe të mbledhësve të krijimtarisë muzikore. Produkt i këtij interesimi janë dy punime, nga të cilat njëri i kushtohet studimeve shumë të rëndësishme të polifonisë së Shqipërisë jugore, të studiuesit të etnomuzikologjisë Benjamin Kruta dhe punimi tjetër *Mbi vlerën dhe rëndësinë e blejve Folklori muzikor shqiptar*, që trajton veprimtarinë e Lorenc Antonit, të botuar në shtatë vëllime me 800 këngë popullore, të cilat janë botim i parë në Kosovë me këngë të melografuara. Sheholli shkruan për vlerën, rëndësinë dhe metodologjinë e punës së L. Antonit në lëmin e etnomuzikologjisë. Ai bën një analizë të materialeve të botuara, trajton metodat e klasifikimit dhe të analizave etnomuzikologjike të strukturave të vargjeve – dy vargjeve, apo strofave melo-poetike si tërësi muzikore të formave të këngëve të paraqitura në vëllime etj.

Në këtë përmbledhje të punimeve janë përfshirë edhe disa recensione

për veprat e disa autorëve nga lëmi i etnomuzikologjisë dhe muzikologjisë.

Kjo përmbledhje punimesh e pasuron shkencën e etnomuzikologjisë shqiptare. Si e tillë mund t'u shërbejë si literaturë e vlefshme studiuesve të etnomuzikologjisë, të muzikologjisë dhe të folklorit, të cilët duan t'i zgjerojnë njohuritë e tyre për të vazhduar thellimin e studimeve të mëtejme të etnomuzikologjisë, gjithashtu mund t'u shërbejë edhe studentëve të muzikës dhe të letërsisë si literaturë ndihmëse, si dhe të gjithë të interesuarve të tjerë për krijimtarinë tonë muzikore tradicionale.

Myzafere MUSTAFA